



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 62 Prot.

Tiranë, më 15.01 2019

VENDIM Nr. 6, datë 15.01.2019

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë"*, Neni 134, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1, datë 15.01.2019, pasi shqyrtoi Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rehabilitimi i Ujësjetës, Tiranë"*-subjekti Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k,

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e Vëzhgimit Arkeologjik sipërfaqësor, në kuadër të *projektit "Rehabilitimi i Ujësjetës, Tiranë"*-subjekti Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Konceptin e sondazheve arkeologjike realizuar nga shoqëri e licencuar në arkeologji "AD-STAR" sh.p.k.
2. Subjekti Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili duhet të kryejë sondazhet arkeologjike, në zonën e përcaktuar në konceptin e miratuar në pikën 1 të këtij vendimi, të ndjekë në mënyrë periodike ditore kryerjen e punimeve të gërmimit për zonën tjetër të zhvillimit të projektit "Rehabilitimi i Ujësjetës, Tiranë", si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.
3. Investitori, Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori Agjencia Kombëtare e Ujësjetës-Kanalizimeve, si dhe subjekti i licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: sekretaria.kka@asha.gov.al

Website: asha.gov.al

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR**



**SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO**